

**UNIVERSITETI I GJAKOVËS**

**“FEHMI AGANI”**

**FAKULTETI I FILOLOGJISË**

**DREJTIMI: GJUHË SHQIPE**



**PUNIM DIPLOME**

**VEPRIMTARIA LETRARE E NAIM FRASHËRIT**

*Mentor:*

*Prof. Asoc. Dr. KAMBER KAMBERI*

*Kandidatja:*

**BRENDA ZEKA**

**GJAKOVË, 2018**

## PËRMBAJTJA

DEKLARATA E KANDIDATES-----	3
Parathënie-----	4
HYRJE-----	6
KAPITULLI I PARË	
1. Jeta dhe veprimtaria letrare e Naim Frashërit-----	8
2.Krijimtaria letrare për fëmijë-----	10
3. <i>Qëllimi i autorit</i> -----	13
KAPITULLI I DYTË	
2. Veprat letrare pë të rritur-----	15
KAPITULLI I TRETË	
1. Identifikimi i njeriut me të bukurën-----	20
2. Glorifikimi i natyrës-----	22
KAPITULLI I KATËRT	
1. Skënderbeu: mit kolektiv dhe realitet historik-----	24
Përfundim-----	28
Literatura-----	29

## **DEKLARATA E KANDIDATES**

Unë, **BRENDA ZEKA**, deklaroj se kjo temë e diplomës, “**VEPRIMTARIA E LETRARE E NAIM FRASHËRIT**”, e llojit të studimit: është punim i imi origjinal. E gjithë literatura dhe burimet tjera që i kam shfrytëzuar gjatë punimit janë të listuara në referenca dhe plotësisht të cituara.

I gjithë punimi është punuar dhe përgatit duke respektuar dhe mbështetur në këshillat dhe rregulloren për përgatitjen e temës së diplomës të përcaktuara nga ana e Universitetit “Fehmi Agani” Gjakovë.

## ***PARATHËNIE***

Punimi synon për një karakter sa më integral dhe ka padyshim vlera njohëse. Gjithashtu synon të japë një panoramë gjithëpërfshirëse të krijimtarisë letrare, lëvruar gjatë periudhës së Rilindjes dhe prek pothuaj gjithë portretet e krijuesve që bënë emër, jo vetëm me veprimtarinë atdhetare dhe diturake, por edhe me veprën e tyre.

Themi që ka meritën që i kushtohet një dege të letërsisë sonë, disi të lënë pas dore, akoma më shumë në ditët e sotme; për shkak të specifikave që ka për shembull: fazën në formimin e karakterit e të shijes estetike të njeriut të ardhshëm, gjuhën e veprës letrare për fëmijë që e veçon nga gjuha e veprës për të rriturit, stilin artistik, figurat stilistike që përdoren në krijimet, tematika e saj, nevojat, aftësitë e mundësitë perceptuese e receptuese të lexuesit të cilit i dedikohet.

Metodat e kërkimit për këtë studim ka qenë një ndër pikësnyimet kryesore për të bërë një trajtim hulumtues, kërkues dhe analizues në fushën e letërsisë.


- Themi hulumtues, sepse çdo punë hulumtuese shkencore ka kërkesat dhe vështirësitë e saj. Edhe në këtë studim duke pasur parasysh hapësirën e madhe të problemeve që i përkasin kësaj fushe, natyrisht jemi munduar të hulumtojmë në literaturat më të fundit për të sjellë profile shkrimtarësh dhe kontributin e tyre në këtë fushë.
- Themi kërkues, për shkak të specifikës që ka letërsia shqipe. Meriton vëmendje dhe kujdes duke u bazuar në kërkimin e vlerave më të mira. Kemi parasysh analizën e veprave të veçanta të autorëve të marrë në studim, duke nxjerrë në pah krijimin letrar që ka bërë autori dhe që i përgjigjet kërkesave që ka kjo fushë.
- Themi analizues, pasi ky punim vjen si studim në fushën e letërsisë, dhe, si e tillë, jemi munduar e përpjekur që të pasqyrojmë e të analizojmë rolin e padiskutueshëm të atyre figurave, personaliteteve që jo vetëm krijuan letërsi të mirëfilltë artistike, por dhanë edhe komente, interpretime apo vlerësime të pjesshme të kësaj letërsie.

Letërsia e Rilindjes Kombëtare shënoi një hap cilësor; ajo u zhvillua si një letërsi artistike në gjini të shkurtra e, megjithatë, ajo nuk mundi të fitonte tiparet e një dege të pavarur në trungun e letërsisë së përgjithshme.

Një nga tiparet e tjera të kësaj tradite letrare, është se rilindësit tanë treguan që kultivimi i letërsisë ishte një mision i madh e i rëndësishëm shoqëror, pedagogjik, artistik dhe kombëtar, letërsi e cila duhej lëvruar për të zhvilluar dhe qytetëruar brezin e ri të Shqipërisë. Ndër ta ishte: Naim Frashëri – poeti ynë Kombëtar i Rilindjes.

Për hartimin e kësaj teme jemi mbështetur në mjaft artikuj e studime që kanë bërë autorët tanë të njohur, por edhe në vetë krijimtarinë e tyre letrare që vitet e fundit është botuar në ringjallje të kësaj kulture të veçantë artistike.

## NAIM FRASHËRI 1846 – 1900



*„Gjuh' që flisjin Perënditë,  
Atë flisjin Pellazgitë;  
Atë kanë Shqipëtarët,  
Si q'e kishin dhe të parët  
Gërqishten ajo e polli,  
Llatinishtja andej dolli.  
Bijtë tanë jan' Elinët  
Sindëkur edhe Llatinët,  
Edhe gjithë Evropanët,  
Qi duallë nga Romanët.  
Neve jemi më të parë,  
Në Evropë nga çdo farë.  
'Gjithë bota vij qëmoti,  
Në Tomor tek ishte Zoti,  
I faleshin Perëndisë,  
Zotit math të Shqipërisë.“*

### HYRJJE

Kontaktet letrare mes popujve lindin dhe vazhdojnë të ruhen natyrshëm. Kultura shqiptare, si çdo kulturë tjetër, ka ditur çfarë të huazojë prej kulturave tjera dhe ka pasur çfarë t'u japë atyre. Në arealin e krijimtarisë letrare shqipe

vërejmë huadhënie, ndikime, pikëtakime dhe kontakte me kulturat e letërsisë tjera botërore.

Letërsia është e kuptueshme për gjithë popujt e botës dhe si e tillë nuk njihet asnjë kufi gjeografik, etnik, fetar e politik. Letërsia gjithashtu llogaritet si njëra ndër letërsitë më të mëdha dhe me ndikim në mesin e letërsive dhe kulturave botërore. Kjo letërsi reflekton mendime morale, kulturore, sociale dhe mistike dhe kështu arriti të pozicionohet meritueshëm në mesin e letërsive të mëdha globale. Përmbajtja dhe mesazhi human i kësaj letërsie ka rezultuar që kjo

letërsi të jetë prezent dhe të ushtrojë ndikimin e saj në vise të ndryshme të botës, përfshirë dhe rajonin tonë.<sup>1</sup>

Veprat artistike të romantizmit edhe te kombet e tjera kanë qenë projeksione imagjinare për kombin, por ato janë racionalizuar nga mendimi politik, filozofik e publicistik, që ka përvijuar aspekte reale e kritike për jetën kombëtare e jetën shtetërore.

Kësisoj, vetëperceptimi në bazë të letërsisë romantike erdhi e u bë vetëperceptim qendror, ndonëse krejtësisht i deformuar. Një popull e komb që gjatë tërë ekzistencës së vet nuk kishte arritur të krijojë kurrë shtet të vërtetë e as të vetëqeveriset, një popull a komb që ishte nën sundime të huaja, i varfër e i katandisur si mos më keq, mori e krijoi një fotografi krejt tjetër për veten e vet, të ngjashme me përshkrimin romantik në poemën e Naim Frashërit:

*Shqipëria kurdoherë*

*Ka qënë shum" e lëvduar,*

*Ka pasur burra të ndjerë,*

*Trima t"urt" e të dëgjuar*

*Pati mbretër e të parë*

*Fort të mëntshim e të mirë,*

*burra, trima, shqipëtarë*

*që kan" emrë të pavdirë.<sup>2</sup>*

---

<sup>1</sup> Abdulla Rexhepi, Mbi gramatikën e persishtes të Naim Frashërit, kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore "Qytetrimi perso – iranian në Ballkan", më 11 mars, 2011, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

<sup>2</sup> Naim Frashëri, Vepra 3, (Istori e Skenderbeut), Rilindja, Prishtinë, 1986, fq. 8

## KAPITULLI I PARË

### Jeta dhe veprimtaria letrare e poetit

Naim Frashëri është përfaqësuesi më i plotë i idealeve të Rilindjes Kombëtare. Është cilësuar si frymëzuesi kryesor i gjithë Rilindjes dhe njëkohësisht poeti më i madh i kësaj periudhe. Atdhetar, mendimtar dhe veprimtar i shquar i arsimit e i kulturës shqiptare.

Naim Frashëri, u lind më 25 maj 1846 në Frashër të Përmetit dhe vdiq më 20 tetor 1900 në Stamboll, ku edhe u varros. Eshtrat e tij janë sjellë në Shqipëri. Në vendlindje bëri mësimet fillore dhe nisi të mësonte persishten pranë teqesë bektashiane. Më 1865 familja u shpërngul në Janinë, ku bashkë me vëllain më të vogël Samiun, mbaroi gjimnazin grek "*Zosimea*" (1869). Bëri pastaj pak muaj në Stamboll, si nëpunës i vogël në zyrën e shtypit (1870), po iu shfaq tuberkulozi dhe u kthye në vendlindje për klimë të mirë. Në fillim ishte nëpunës në Berat e më pas edhe drejtues i doganës në Sarandë (1872-77). Në këtë periudhë Naim Frashëri bëri prova të vjershërimit shqip, nën ndikimin e bejtexhinjve e u dha pas vjershërimit persisht, me sukses, duke botuar më vonë edhe një përmbledhje lirikash *Tejhyjylat (Ëndërrimet, 1885)*. Në ndikimin e ngjarjeve historike, sidomos të *Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, njëri nga udhëheqësit e së cilës ishte Abdyl, vëllai i tij më i madh, dhe të veprimtarisë kulturore patriotike të *Shoqërisë së Stambollit*, në krye të së cilës ishte Samiu, Naim Frashëri braktisi vjershërimit persisht dhe iu kushtua letërsisë shqiptare. Poema e tij e parë e re ishte "*Shqipëria*" (1880, botuar më 1897), që entuziazmoi patriotët shqiptarë. Në Stamboll, Naim Frashëri, ka qenë ndër botuesit kryesorë të revistës "*Drita*", më pas "*Ditura*" (1884-85), ku u botuan shumë vjersha të tij, proza e vargje për shkollat e para shqipe që do të hapeshin, disa shqipërime të shkrimtarit. Ai shërbente si anëtar i *Komisionit të Botimeve*, e më pas si kryetar.

Më 1886, Naim Frashëri, botoi poemën e tij të famshme "*Bagëti e Bujqësi*", atë greqisht "*Dëshira e vërtetë e shqiptarëve*" (O alithis pothos ton Albanon) dhe katër libra për shkollat: "*Vjersha për mësonjtoret e para*", "*E këndimit të çunavet këndonjëtoreja*", (në dy vëllime, me poezi, lexime të ndryshme, njohuri të para shkencore humanitare), si dhe një "*Histori të përgjithshme*". Më 1888 vijoi me "*Dituritë*" (ribotuar më 1895 me titullin "*Gjithësia*", - shkenca të natyrës). Më 1890 doli përmbledhja e lirikave "*Lulet e verës*", pastaj "*Mësimet*" (proza patriotike dhe të moralit) dhe "*Fjala flutarake*" (vjersha) më 1894, së fundi më 1898, poema e madhe epike "*Historia e Skënderbeut*" dhe poema fetare "*Qerbelaja*" etj.

Naim Frashëri, u shqua për lirikën e tij patriotike me temë aktuale (vjershat "*Gjuha shqipe*", "*Korçës*" 1887 etj.), u këndoi me pasion të rrallë mallit dhe bukurive të atdheut ("*Bagëti e bujqësia*") dhe bëri thirrje të fuqishme për çlirimin e tij (krijime të ndryshme, "*Dëshira e vërtetë e shqiptarëve*", si dhe për begatimin e vendit dhe një të ardhme demokratike të tij. Ai, i këndoi natyrës, dashurisë (poema "*Bukuria*", një ndër kryesoret e tij, 1890), miqësisë, jetës intime, brengën atdhetare etj. Poema "*Historia e Skënderbeut*", një kurorëzim i veprës së tij,



*"testamenti i tij politik e poetik"*, me thirrje të hapëta për çlirim nga Turqia, e cila është shkruar sipas traditës së madhe barletiane. Në poemat epike ai u ndikua nga historitë e vjershëruara të Lindjes dhe nga bejtexhinjtë *frashëriotë*, po duke iu kundërvënë këtyre me shqipen e kulluar apo me shkarkimin e dogmës fetare (në *"Qerbelaja"* dhe në veprat e tjera, që i hartoi për afrimin e elementit besimtar në lëvizjen kombëtare).

Naim Frashëri, u shqua edhe për poezinë meditative, nisi në shqip poezinë filozofike (vjersha *"Perëndia"* 1890). Shkroi dhe proza për të vegjlit dhe bëri disa përshtatje mjeshtërore fabulash të *La Fontenit*. Botëkuptimi i Naimit, ishte në thelb panteist (mishërimi i natyrës me Zotin) e idealist. Me admirimin e madh që kishte për racionalizmin e *Dekartit* dhe si pasues i shquar i iluministëve francezë Volter, Ruso etj., me besimin në shkencat dhe në rolin e tyre në shoqëri (pranimi i teorisë Kant-Laplas. Me demokratizmin e tij, besimin në aftësitë e pashtershme të popullit të vet për të qëndruar, për t'u çliruar, për të vajtur përpara me hov, Naim Frashëri u bë një veprimtar i pashoq në tërë fushat, si shkrimtar, njeri i mendimit, njeri politik etj. E gjithë veprimtaria e tij letrare dhe kulturore ishte e lidhur ngushtë me çlirimin dhe përparimin e vendit. Me çlirimin shpirtëror, arsimimin dhe ndriçimin e masave të popullit. Ai kishte besim të plotë në aftësinë e mendjes për të njohur realitetin e për të vënë në shërbim të njeriut njohjen e ligjeve të botës. Kërkonte arsimim për të gjithë, emancipimin e gruas, qeverisjen demokratike, të vendit (një *"demokraci prej pleqet"*, pra të një ngjyre shqiptare), ngrinte lart vetitë e karakterit të shqiptarëve (besën, trimërinë, bujarinë), traditat kombëtare që nga lashtësia pelazgjike. Bënte thirrje për miqësi me fqinjët në kushtet e respektit reciprok, shpallte dashurinë në gjithë popujt e racat, ngrihej me forcë kundër së keqes, pansllavizmit, duke admiruar vetitë dhe kulturën e popujve të tjerë (poezinë përparimtare lindore, atë greke, latine, rilindjen evropiane, romantizmin evropian, prej të cilave dhe u ndikua).

Naim Frashëri, luajti, përkrah Samiut e pas Kristoforidhit, një rol themelor për shqipen e re letrare, të cilën e shkroi me një pasuri të veçantë fjalori e sidomos frazeologjike, duke u mbështetur kryesisht në gjuhën e popullit, e shkroi të pastër dhe bëri një punë të dukshme për pasurimin e saj, duke e ngritur atë në lartësinë e një gjuhe arti të zhvilluar dhe kulture. Ndikimi i Naim Frashëri, me gjallje të shkrimtarit dhe pas vdekjes, jo vetëm të shkrimtarët shqiptarë të kohës, por edhe të periudhës së mëvonshme, ishte i madh. U vunë në pah dhe u çmuan gjerësisht meritat dhe vlerat e punës dhe të krijimtarisë së tij, përmes studimesh të ndryshme. Ribotimet e veprave të tij janë të shumta; përveç tyre janë bërë edhe disa botime kritike shkencore të veprave të Naimit.

*Veprat: "Tejhyjlat" (Ëndërrimet, 1885), "Shqipëria" (1880, botuar më 1897), "Bagëti e Bujqësi", 1886, "Dëshira e vërtetë e shqiptarëve" (O alithis pothos ton Albanon), "Vjersha për mësonjtoret e para", "E këndimit të çunavet këndonjëtoreja", (në dy vëllime, me poezi, lexime të ndryshme, njohuri të para shkencore e humanitare), "Histori të përgjithshme", "Luleteverës" 1890, "Mësimet", (proza patriotike dhe të moralit), "Fjala flutarake", (vjersha)*

1894, “*Historia e Skënderbeut*”, (poemë epike) 1898, “*Qerbelaja*” (poemë fetare), “*Perëndia*”, 1890, “*Fjalët e Qiririt*” (publikuar për herë të parë në numrin e parë të revistës “*Drita*”, etj.

### ***Krijimtaria letrare për fëmijë***

Krijimtaria letrare për fëmijë e Naimit është mjaft e gjerë dhe e pasur. Ai ka qenë ndër të parët rilindës që kuptoi nevojën e krijimtarisë për fëmijë si mjet të rëndësishëm për emancipimin kulturor e shpirtëror të brezit të ri. Në konceptin e tij filozofik shprehet motivi i qartë i tij ”s’ mjafton të bëhet Shqipëria”, po ”duhen bërë edhe shqiptarët”.<sup>3</sup> Në vitet 1884-1885, së bashku me Jani Vreton dhe me Samiun, botoi revistën kulturore *Drita* ( e cila pas disa numrash u titullua *Dituria*), gjithsej 12 numra, ku veç poezive për të rriturit, filloi të publikonte edhe shkrime mësimore e letrare për të vegjlit.

Veç veprave për të rritur (“*Bagëti e bujqësi*”, “*Lulet e verës*”, “*Historia e Skënderbeut*”, “*Qerbelaja*” etj.), Naimi botoi edhe tekste për shkollat e para shqipe “*Histori e përgjithshme*”, “*Histori e Shqipërisë*”, “*Dituritë*” (në botimin e dytë të saj u titullua *Gjithësia*), si dhe tre libra të tjerë, ku përmbledhet kryesisht edhe krijimtaria e tij letrare për fëmijë:

“*Vjersha për mësonjëtoret e para*”, *Bukuresht 1886*,

“*E këndimit çunavet këndonjëtoreja*”, *Bukuresht 1886*

“*E këndimit çunavet këndonjëtoreja*”, , *Bukuresht 1886*.<sup>4</sup>

Në tërë këtë krijimtari letrare për fëmijë, Naim Frashëri na shfaqet jo vetëm si shkrimtar e poet i shquar por, njëherësh edhe si pedagog i madh. Me tregimet e shkurtra në librin “*E këndimit çunavet Këndonjëtoreja*”, ai u cilësua si prozator i talentuar për të vegjël, ndërsa me artin poetik, në përmbledhjen *Vjersha për mësonjëtoret e para*, ai u bë themeluesi i poezisë për fëmijë. Merita më e veçantë e Naimit në këtë krijimtari letrare qëndron se ai ngriti letërsinë për fëmijë në një nivel më të lartë artistik, duke ndikuar fuqishëm tek rilindësit e tjerë.

Në vështrimin e përgjithshëm të kësaj letërsie Naimi si poet dhe shkrimtar nëpërmjet gjinive dhe llojeve të ndryshme, synon t’u japë këshilla, të përcjellë urtësi dhe filozofi por edhe të rrezatojë edhe elemente të kulturës dhe edukatës, të sjelljes dhe moralit. Ai, iu përkushtua letërsisë për fëmijë për të ndikuar thellë në ndërgjegjen e moralin e fëmijëve. Ishte i bindur se

<sup>3</sup> Nonda Bulka, “Naimi dhe fabulat”, *Nëntori*, Nr. 5, 1971, f. 51

<sup>4</sup> Qosja Rexhep, *Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi I-III, Rilindja, Prishtinë, 1970.*

themelet e kulturës gjuhësore të kombit vihen në shkollë dhe në vegjëli. “*Djemt’ e vegjël e vashat e vogëla lipsetë të mësojnë gjuhën e tyre, ta këndonjë drejt, e ta shkruajnë mirë*”.<sup>5</sup>

Në këtë mënyrë proza dhe poezia për fëmijë i nënshtrohen qëllimit të tij: edukimit artistik dhe atdhetar të fëmijëve. Një nga tiparet themelore të krijimtarisë letrare për fëmijë është se ai përmbledh e shkruan vjersha, proza e krijime që u drejtohet fëmijëve, ku ata janë personazhe. Në krijimtarinë letrare për fëmijë dallohen edhe proza të shkurtra, disa prej të cilave kritika letrare i ka quajtur skica. Nga këto krijime disa krijime kanë veçori të tregimit, disa të fabulës, nëpërmjet të cilave në botën e fëmijëve sjellin njohuri mbi natyrën, shoqërinë dhe gjithësinë. Në tregimin *Vash’e urtë*, fëmijët mësojnë për Diellin dhe yjtë e tjerë. Si janë krijuar? Si lëvizin në hapësirë? Në radhët e këtyre tregimeve natyrshëm përcillen mendime të urta e këshilla, siç ndodh në këtë rast kur e ëma i thotë së bijës: ”Këndo e mëso të març vesh gjithësinë edhe Perëndinë”.<sup>6</sup>

Ndërsa te tregimi “*I urti dhe i marri*” kallëzohet sesi fëmija i urtë mëson, prandaj kujdeset të jetë i pastër, kurse përballë tij qëndron i marri, i prapti, i cili jo vetëm nuk mëson por mbart edhe vese. Në prozën me titull *Kalorësi*, Naimi e shquan porosinë: njeriu duhet të pranojë zemërgjerë, si të mirën ashtu edhe të keqen, sepse e keqja, herë-herë, mund të ketë të mirë.

Duke synuar edukimin artistik dhe atdhetar të fëmijëve, Naim Frashëri ka hartuar proza të shkurtra: “*Aristoteli*”, “*Ipokrati*”, “*Themistokliu*” në të cilat shpalosen njohuri historike, ngjarje dhe personazhe historike, duke shfrytëzuar tharmin e anekdotave historike. Proza për Aristotelin përbëhet prej dialogut ndërmjet filozofit grek dhe nxënësit të tij, Aleksandrit të Maqedonisë, për rindërtimin e qytetit të Stagirës, që e kishte rrethuar i ati, Filipi i Maqedonisë. Hipokrati, jep dialogun ndërmjet mbretit të Persisë, që e fton Hipokratit të shkojë të jetojë pranë tij dhe këtij mjekut grek që i përgjigjet: Nuk mund të lë nevojën e mëmëdheut tim e të ndjek të mirën tuaj. Nëpërmjet dialogëve dhe kallëzimeve, shkrimtari ndërton një botë interesante për fëmijët.

Në prozën e Naim Frashërit zënë vend edhe mjaft përshkrime, përralla e anekdota mbi jetën e kafshëve. Të tilla janë tregimet: “*Qeni dhe besa e tij*”, “*Kali*”, “*Qeni*”, “*Qengji*”, “*Dimri*” etj. Te tregimi i parë, lexuesit i ngel në mendje figura e qenit Xhuf, i cili jep jetën për të ruajtur pasurinë e të zot. Në tregimin *Dimri* kemi një vajzë të mbarë, Kaçen, që gjatë stinës së ftohtë ushqen një zog të vogël, i cili miqësohet me vogëlushen. Në prozën për fëmijë të Naim

---

<sup>5</sup> Naim Frashëri, “E këndimit çunavet Këndonjëtoreja”, copë e dytë, shtypurë prej Shoqërisë Drita, Bukuresht 1886, f. 3

<sup>6</sup> Po aty. Fq.38

Frashërit vihet re prirja romantike për të pasqyruar temën historike të ndërlidhur me temën bashkëkohore. Një nga tiparet që e karakterizojnë prozën e tij janë situatat, ndodhitë dhe trimëritë në të cilat gjallërojnë fjalët e mençura dhe të urta, shpeshherë marrin kuptimin e gojëdhënave të cilat realizojnë mesazhe diturore, morale dhe artistike të fëmijët.

Të gjitha prozat për fëmijë të Naim Frashërit kanë përmbajtje fare të thjeshtë, të dhëna në vija të përgjithshme, pa thellime psikologjike dhe tematike, në të cilat vetëm sa përvijohen idetë e porositë morale. Në to rregullisht ballafaqohen ide të kundërta, e mira dhe e keqja, e bukura dhe e shëmtuara, urtësia e mosdija. Në krijimtarinë letrare për fëmijë të N. Frashërit një vend të rëndësishëm zë poezia. Ky art poetik zë një vend të veçantë të Vjersha për mësonjëtoret e para (1886), libër që është i pari vëllim me vjersha në historinë e letërsisë shqiptare për fëmijë, por edhe në përmbledhjen Parajsa dhe fjala fluturake (1894). Si sasi është më e madhe se proza, ndërsa nga përmbajtja poezitë dhe prozat janë të afërta dhe të ngjashme.

Vjershat e Naim Frashërit për fëmijë, në përgjithësi, janë më të përbëra, kuptimisht më të ngjeshura, prandaj edhe më të rënda për përvetësim: ato janë vjersha që u dedikohen fëmijëve po aq sa u dedikohen edhe të rriturve dhe për këtë arsye kërkojnë ndihmën e prindit e të mësuesit. Kjo duket në vjershën Fjalët e qiririt (që, megjithëse është futur te teksti “Vjersha për mësonjëtoret e para” është më tepër krijim për të rriturit), ku poeti shpalos misionin e tij si edukator, që porsiqiri i ndezur, duhet të digjet e të përvëlohet, vetëm e vetëm të ndriçojë mendjen e njerëzve. Duke zotëruar idetë iluministe, poeti ynë kërkon të përsosë moralisht njeriun (fëmijën), të përcjellë tek ai mendime e ide për “mbrothësinë” dhe qytetërimin.<sup>7</sup>

Për popullarizimin e njohurive të këtij karakteri në shkrimet e veta poeti ynë shpeshherë ka krijuar pasazhe me nuanca emocionale, të përshtatshme për të plotësuar kërkesat e fëmijëve dhe në përputhje me psikologjinë e tyre. Nëpërmjet figurave poetike fëmijët ngulitin në mendjen e tyre disa të vërteta shkencore dhe të natyrës. Në to mund të mësohet se Toka është trup qiellor që sillet rreth Diellit, kurse Hëna rreth Tokës. Kështu përmes mënyrës së qëlluar personifikuese të trupave qiellore, autori ka bërë karakterizimin e planetit tonë me anë të këtyre vargjeve lakonike në vjershën *Gjithësija*:

*Dheu është një yll i qiellit,  
që lëvrin në hapësirë,*

---

<sup>7</sup> Rexhep Qosja, Shkrimtarë dhe periudha, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1975, fq.370

*i vjen rreth e rrotull Diellit,  
merr të ngrysur e të gdhirë,  
Djellinë e ka atë,  
E hënënë e ka bijë,  
Bashkë me ta dit' e natë  
Rron si ç'është një fëmijë.<sup>8</sup>*

Naimi si një shkrimtar i shquar dhe pedagog, përmes krijimeve, synonte aktivizimin e mendimit intelektual e arsimor si dhe emancipimin moral shpirtëror të fëmijëve. Kështu, në mjaft vjersha të ciklit “*Fjalët e t'urtëve*”, nga pozita të përparuara për kohën, jepen mësimet e porosi morale që i vlejshëm çdokujt në jetë, bëhet vlerësimi i virtyeteve dhe i ndjenjave të pastra njerëzore, flitet për rëndësinë që ka puna dhe dija në jetën e njeriut, qortohen veset e dëmshme, lartësohen ndjenjat fisnike të dashurisë për gjuhën, Atdheun, prindërit, shokët etj. Në të shumtën e herës mësimet e porositë morale në to jepen në formë lakonike, me ton të qetë prindëror dhe në mënyrë të poetizuar, duke përdorur për këtë qëllim figura stilistike, përsiatje dhe asociacione të thjeshta.

### ***Qëllimi i autorit***

Karakteristikë e fabulave është origjinaliteti i tyre.<sup>9</sup> Ai merr nga burimi disa detaje a elemente dhe i përpunon e i zhvillon më tej me mënyrën e vet të shprehurit, me stilin e tij individual, me talentin e vet poetik. Të bie në sy në to edhe fryma romantike e jetës. Kafshët humanizohen dhe jepen si bartëse të virtyeteve e të veseve njerëzore.

Në fabula nuk është vetëm didaktik e moralizues. Naimi përpiqet së pari të na japë një krijim të bukur artistik. Dhe, pasi lexuesi të jetë kënaqur me ngjarjen tërheqëse, me detaje të ndryshme, me dialogjet dhe sjelljet e ndryshme të personazheve kafshë, autori arrin në porosinë morale.

Fryma popullore është mjaft e pranishme në këto fabula. Edhe fillimi i tyre shpesh është si në përrallat tona, pa zgjatje, por duke përshkruar mjedisin ku do të zhvillohet ngjarja. Kësisoj, fabulat e Naim Frashërit janë krijime poetike pothuajse origjinale. Duke përfunduar themi se

---

<sup>8</sup> Naim Frashëri, “Vepra të zgjedhura 2”, Prishtinë 1978, f. 17

<sup>9</sup> Astrit Bishqemi, “Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë”, Elbasan, 2001, f. 60

Naim Frashëri e ka pasuruar letërsinë shqipe për fëmijë si me larminë e përmbajtjeve ashtu edhe me larminë e trajtave poetike. Me Naimin u çel një traditë e re letrare që do të zgjerohej e pasurohej më tej nga pasardhësit. Pikërisht për këtë kontribut të shënuar që solli, Naimi, ka merituar pagëzimin e themeluesit të letërsisë shqipe për fëmijë dhe të përfaqësuesit kryesor të saj gjatë Rilindjes Kombëtare.

## KREU I DYTË

### *Veprat letrare për të rritur*

Veprimtaria letrare e Naim Frashërit është mjaft e gjerë dhe e shumanshme. Ai, pos veprave për të vegjlit shkroi edhe vepra për të rritur me motive të ndryshme. Kryesisht shkroi në poezi. Ndër këto vepra do të veçojmë disa prej tyre për të bërë një vështrim të përgjithësuar. Ashtu siç na lejon natyra e këtij punimi.

*"Bagëti e bujqësi"*, kjo poemë u botua në vitin 1886. Është një nga veprat më të bukura e më të frymëzuara, jo vetëm të Naimit, por edhe të gjithë letërsisë së Rilindjes. Askush para Naimit nuk i kishte kënduar dashurisë e mallit për atdhe, krenarisë kombëtare dhe bukurisë së natyrës shqiptare me një frymëzim aq të zjarrtë e me një gjuhë poetike aq të ëmbël e të bukur. Me këtë poemë, Naimi krijoi poezinë e madhe të atdheut e të natyrës shqiptare. Kjo vepër jo vetëm që u bë e dashur për bashkatdhetarët, por krijoi një traditë të pasur edhe për poetët që erdhën më pas.

Siç e tregon edhe titulli, poema përbëhet nga dy pjesë. Në pjesën e parë flitet për punët e blegtorisë, për jetën dhe punën e bariut, kurse në pjesën e dytë për punët e bujkut. Megjithatë, kjo s'është aspak një vepër për këto fusha të jetës. Prej tyre poeti vetëm sa merr pikënisje për të shprehur ndjenjat e flakta patriotike. Në të vërtetë, vepra është një himn poetik i frymëzuar, kushtuar Atdheut, natyrës dhe njerëzve të tij. Poema hapet me një apostrofë madhështore, e cila me një qartësi të habitshme na sjell para syve bukuritë e natyrës shqiptare, larminë dhe ngjyrat e saj, një peizazh të pafund plot dritë e gjallëri.

*"O malet e Shqipërisë e ju, o lisat e gjatë,*

*fushat e gjera me lule që u kam ndër mend ditë natë,*

*ju, bregore bukuroshe, e ju, lumenjtë e kulluar,*

*çuka, kodra, brinja, gërxhe dhe pyje të gjelbëruar,*

*do të këndoj bagëtinë që mbani ju e ushqeni*

*o vendëthit e bekuar ju mendjen ma dëfreni."*

Motivi i mallit për atdhe zë fill që në këto vargje dhe e përshkon gjithë poemën. Larg vendlindjes, larg maleve dhe fushave, larg netëve të magjishme dhe mëngjeseve plot zhurma jetësore, poeti ndjen një mall që e djeg nga brenda për çdo gjë shqiptare. Në atdhe gjithçka është e bukur, ndaj edhe dëshira për t'u kthyer është e papërmbajtur. Kjo dëshirë për të fluturuar drejt Shqipërisë është shprehur me mjete poetike nga më të ndjerat. Poeti dëshiron të ketë "vrapin e

veriu... krahë pëllumbi..., nxitimin e lumit me valë". Me apostrofa plot drithërim ai i drejtohet "fluturës krahëshkruar" ose "dallëndyshes bukuroshe" që t'ia marrin zemrën e përmalluar e t'ia shpien në Shqipëri. Veçanërisht e goditur është "similituda", e ndërtuar mbi bazën e përfytyrimeve popullore të marra nga jeta e bariut dhe e bujku shqiptar:

*"Kur dëgjon zëthin e s'ëmës qysh e lë qingji kopenë*

*blegërinë dy a tri herë edhe ikën e merr dhenë,*

*edhe në i prefshin udhën njëzet a tridhjetë vetë,*

*e ta trembin ai s'kthehet, po shkon në mes si shigjetë.*

*Ashtu dhe zemra ime, më lë këtu, tek jam, mua,*

*vjen me vrap e me dëshirë aty, në viset e tua."*

Një tjetër motiv i fuqishëm, që e bën poemën të dashur e frymëzuese edhe për ne sot, është krenaria për Shqipërinë, krenaria për emrin shqiptar. Me dashurinë dhe krenarinë e flaktë atdhetare, Naimi shprehu një nga idetë më të rëndësishme të lëvizjes kombëtare. Ai synonte të ngjallte tek bashkatdhetarët ndërgjegjen kombëtare, t'i bënte të vetëdijshëm se ishin bij të një vendi me vlera të gjithanshme, të një atdheu që priste shumë prej tyre. Zëri i poetit buçet:

*"Ti Shqipëri, më ep nder, më ep emrin shqipëtar,*

*zemrën ti ma gatove plot me dëshirë e me zjarr."*

Vlerat artistike të poemës janë të gjithanshme, ndaj dhe idetë e saj janë aq të prekshme. Figuracioni është aq i pasur, i larmishëm e i vetvetishëm sa të krijoj një ngazëllim të papërmbajtur. Duke u nisur nga jeta baritore, nga loja e qengjave rreth mëmave të tyre, Naimi krijon edhe simbole shprehëse: fjala "mëmë" përsëritet aq shpesh, sa bëhet simbol, që përgjithëson përkushtimin e poetit ndaj tokës mëmë, Shqipërisë. Në këtë vepër Naimi përdor një shqipe të kulluar dhe, mbi të gjitha, arrit të zbulojë me forcën e talentit poetik vlerat dhe mundësitë e mëdha shprehëse të gjuhës sonë. Ai e ngriti atë në rrafshin e gjuhës së poezisë së vërtetë, që mund të shprehte ndjenja nga më të hollat.

Me "**Lulet e verës**" Naimi arriti pjekurinë e plotë si poet lirik. Larmia e motiveve, pasuria dhe thellësia e ndjenjave kanë përcaktuar edhe përdorimin e një gjuhe poetike të larmishme e me shprehësi të lartë. Sa optimist e i ngazëllyer është kur shpreh besimin tek e ardhmja, aq i përmbajtur e meditues është kur flet për probleme të qenies, të filozofisë, sa i trishtuar paraqitet kur kujton djalërinë e perënduar, kohën e ikur, dhe të vdekurit, aq i përndezur është në urrejtjen e tij kur mallkon tradhtarët. Naimi përdori mjete të shumta stilistike. Epitetet e goditura për gjuhën, anaforat tek vjersha "Fyelli", shpërthimet në formë pashirmash "Lum kush të rrojë...", krahasimi i Korçës së Mësonjëtores së parë me trimin që sulet në ballë etj., mbeten të pashlyera në kujtesë. Me shumë efekt poeti përdori edhe antitezat, veçanërisht ndërmjet disa fjalëve të caktuara me kuptim të përgjithshëm, por që ai i shënoi me një përmbajtje të qartë e me



ngarkesë emocionale (drita-errësira; fatbardhësia, mbarësia, qytetaria, ndarja, marrësia), që përfaqësojnë të parat: lirinë, emancipimin, kurse të dytat: zgjedhën, paditurinë, si plagë të pushtimit.

Motivet kryesore që trajtoi Naimi në përmbledhjen "*Lulet e verës*" janë tri: *motivi patriotik, motivet filozofike dhe motivi i dashurisë*. Vjershat e motivit patriotik janë lirika që shprehin ndjenjat qytetare të poetit ndaj atdheut. Një nga përjetimet më të fuqishme të këtij motivi është besimi i palëkundur në të ardhmen e Shqipërisë. Motivi filozofik zë vend të rëndësishëm te "*Lulet e verës*" dhe mund të themi se Naimi themeloi në letërsinë shqiptare traditën e poezisë së mendimit. Në lirikat filozofike gjejmë përsiatjet e poetit për botën, për jetën dhe vdekjen, për njeriun, perëndinë. Për herë të parë në letërsinë shqiptare trajtohen kaq gjerë koncepte të tilla filozofike, një botë përjetimesh që kanë në qendër njeriun.

*Vjershat e motivit patriotik* ("Shpreh", "Përse", "Gjuha jonë", "Korça", "Tradhëtorët" e ndonjë tjetër) janë lirika që shprehin ndjenjat qytetare të poetit ndaj Atdheut, vlerave të tij dhe fateve të tij.

Dy vjersha që lidhen ngushtë nga idetë dhe patosi që i përshkon, janë "Gjuha jonë" dhe "Korça". Në to ai i ka thurur gjuhës shqipe vargjet më të frymëzuara. Është ndër të parët poetë që i këndoi bukurisë dhe ëmbëlsisë së gjuhës sonë, është ndër të parët që kuptoi vlerat dhe mundësitë e saj të shumta për të shprehur mendimet dhe ndjenjat më të thella njerëzore:

*"Gjuha jonë sa e mirë!  
Sa e ëmbël! Sa e gjerë!  
sa e lehtë! Sa e lirë!  
Sa e bukur! Sa e vlerë!" ("Korça")*

Naimi shkruan plot entuziazëm për hapjen e shkollës së parë shqipe në Korçë më 1887 dhe u bën thirrje bashkatdhetarëve të hyjnë me guxim në rrugën e diturisë e të kulturës. Kur ai thotë: "Të marrim diturinë..., tani lipsetë dritë ("Gjuha jonë"), kemi prirjet e tij iluministe dhe përfytyrim se liria nuk shpëtohet nga përparimi, nga qytetërimi.

*Motivi filozofik* zë vend të gjerë në "*Lulet e verës*" dhe mund të themi se Naimi themeloi në letërsinë shqiptare traditën e *poezisë së mendimit*. Në lirikat *filozofike* gjejmë përsiatjet e poetit për botën, për jetën dhe vdekjen, për njeriun, perëndinë, për kohën që shkon pa kthim. Për herë të parë në letërsinë shqiptare trajtohen kaq gjerë përfytyrime të tilla filozofike, një botë përjetimesh që kanë në qendër njeriun. Me sinjeritet e me gjuhë plot emocione, Naimi shpreh ide humane, dashurinë dhe besimin e tij ndaj njeriut. Në disa nga vjershat filozofike, si: "Jeta", "Zemra" e sidomos "Perëndia", spikat qartë një nga elementet bazë të botëkuptimit të Naimit, panteizmin. Shfaqet aty nga ana mistike e këtij botëkuptimi, por nga ana tjetër, edhe mohimi i riteve të tepruara fetare. Ai pohon se perëndia është kudo, e shkrirë, e trupëzuar te çdo send a gjallesë e botës:

*"Ç`sheh, është zot` i vërtetë,  
Ç`dëgjon, është zër` i tija,  
Gjithë ç`ka e s`ka në jetë,  
Është vetë perëndia" ("Perëndia")*

Në panteizmin e Naimit depërton edhe humanizmi, besimi i madh i poetit te njeriu, që është genia më e lartë e gjithësisë, sepse tek ai, sipas poetit, personifikohet vetë hyjnia.

Motivi erotik është trajtuar në një cikël të tërë vjershash me titullin e përbashkët "**Bukuria**". Lirikën e dashurisë e kishin lëvruar edhe bejtexhinjtë, por Naimi e ngriti në një nivel artistik të ri. Shpesh përcolli edhe përfytyrime etike e filozofike.

Poeti i këndoi bukurisë së vashës, para së cilës mrekullohet edhe në të zbulon një pjesë të bukurisë universale. Ai e koncepton atë si shfaqje të përsosmërisë njerëzore, të harmonisë dhe bukurisë hyjnore. Ndihet në to edhe ndikim i poezisë orientale. Heroi lirik të kujton bilbilin, kurse vajza e dashur trëndafilin, figura konvencionale të asaj poezie. Ndjenja e poetit është platonike, abstrakte, dhe nuk ka atë shfaqje konkrete si në lirikën popullore ose më vonë si në poezinë e Çajupit. Si romantik, Naimi këndoi më shumë vuajtjet që sjell dashuria, sesa gëzimet e saj. Në këto ndjenja, zbulohet një zemër shumë e ndjeshme dhe mbi të gjitha, shumë njerëzore. Dashuria për poetin është gjithmonë një ndjenjë e lartë, fisnike dhe e pastër.

Në ciklin "**Bukuria**" afrimi me poezinë popullore është mjaft i dukshëm. Poeti mori prej saj mjete artistike e teknika vëzhgimi dhe krijoi vargjet plot natyrshmëri e bukuri të rrallë:

*"Bukuroshe, sy mëshqerrë,  
shikomë njëherë mua,  
trëndafil i kuq me erë  
e di, vallë, se sa të dua?  
E mora vdekjen në sy,  
do të vdes, të vdes për ty".*

### **"Historia e Skënderbeut"**

Poema epike "**Historia e Skënderbeut**" u botua më 1898. Kjo vepër e fundit që botoi ai, mbeti si testamenti i tij, sepse në të përmbloodhi dhe shprehu me patos të fuqishëm idealet për lirinë e Shqipërisë dhe për futjen e saj në rrugën e përparimit. Vepra doli në një çast historik tepër të mprehtë: Perandoria Osmane po shkonte drejt fundit të saj dhe rreziku i copëtimit të vendit tonë nga shtetet shoviniste ishte shumë i madh. Kërkohej më shumë se kurrë që ndërgjegjja kombëtare të forcohej dhe, veç kësaj, te shqiptarët të krijohej mendësia se ishte e drejta e tyre të jetonin të lirë si komb më vete në trojet e lashta stërgjyshore. Vepra e Naimit bënte thirrje dhe nxiste shqiptarët t'i dilnin zot vendit të tyre në këto kushte, duke kryer me nder detyrën atdhetare. Breza të tërë patriotësh kishin ëndërruar të kishin një vepër për heroin kombëtar, Skënderbeun. Këtë dëshirë e realizoi Naimi me poemën e vet madhore, e cila lëshoi hapur e me forcë kushtrimin për të rrokur armët, për të shkundur zgjedhën turke e për ta mbrojtur atdheun nga çdo rrezik. Ajo tingëlloi si kushtrim i bashkimit të shqiptarëve rreth flamurit të Skënderbeut. Si është ndërtuar vepra? "**Historia e Skënderbeut**" është një poemë epike e përbërë nga 22 këngë. Ngjarjet ndjekin rendin kohor: Fillojnë me dërgimin e djemve të Gjon Kastriotit peng të sulltanit dhe mbarojnë me vdekjen e Skënderbeut dhe pasojat e rënda që ndoqën. Në përgjithësi vepra i përmbahet historisë, ndonëse ka personazhe të krijuara prej poetit. Në qendër të poemës është figura e Skënderbeut. Këtë figurë Naimi e ka vizatuar në përputhje me idealin e tij romantik, në dritën e idealeve të humanizmit evropian e në frymën e Rilindjes. Pra e idealizon figurën e heroit tonë. Për Naimin Skënderbeu është personifikim i të gjitha vlerave: i trimërisë, i urtësisë, i bukurisë fizike e morale:

Ishte mbret i bukurisë, si dielli epte dritë..., ... kish të gjitha mirësitë dhe të tërë urtësinë, njerëzin' e dituritë dhe fuqin' e trimërinë.

Naimi e paraqet Skënderbeun me tiparet e një heroi legjendar, të luftëtarit kreshnik dhe të atdhetarit të flaktë, që mbi gjithçka vë atdheun, edhe mbi interesin e tij. Në poemë e gjejmë Skënderbeun një udhëheqës me aftësi të rralla, që diti të bashkonte të gjithë shqiptarët rreth idealit të madh të lirisë. Ai është organizator dhe strateg i madh në luftë, po aq sa është edhe luftëtar që bie "si rrufë" mbi armiqtë dhe i shpartallon. Si prijës i urtë popullor ai është simbol i lirisë, i traditave heroike të popullit, i idealeve shoqërore e demokratike që i kishte vetë poeti. Skënderbeu paraqitet me një botë tepër humane. Është i dashur e i thjeshtë me njerëzit, ka një mall përvëlues për atdheun kur jeton larg tij, qan me lot të hidhur kur merr vesh vdekjen e njerëzve të afërt dhe të zezat që e gjetën Shqipërinë. Në çdo çast është njerëzor e fisnik. Figura e Skënderbeut është e pashkëputur nga epoka e tij. Është e natyrshme që këtë epokë Naimi ta paraqitë të idealizuar, duke ia kundërvënë gjëndjes së Shqipërisë së robëruar e të prapambetur të kohës së vet. Koha e Skënderbeut përmblihte gjithë "mirësitë" e "begatitë" atëherë mbretëronte urtësia, paqja, kamja, nderi, shpresa. Paraqitja e idealizuar e së kaluarës kishte një funksion të caktuar. Duke ballafaquar dy epokat, Naimi thekson se pushteti osman e ndërpreu procesin e zhvillimit e të qytetërimit të Shqipërisë, e hodhi këtë në errësirë. Pra, pushtimi osman duhej shpërrur sa më parë dhe epoka e lavdishme e Skënderbeut duhej përtërirë. Naimi evokon shpirtin heroik e liridashës të shqiptarëve, traditat e tyre të bashkimit, evokon epokën dhe Skënderbeun vetëm e vetëm që *"T'i ap dritë Shqipërisë, Nga shpirt' i ndritshëm i tija"*.

Pra, duke na i paraqitur ato si një model të përsosur, ti frymëzonte bashkatdhetarët për ta çliruar e qytetëruar atdheun e tyre si dikur. Si demokrat Naimi e paraqet popullin si një forcë të gjallë që i udhëhequr nga një hero si Skënderbeu, korr fitore dhe tregon heroizëm e patriotizëm të pashoq. Një ide e rëndësishme e poemës, tepër aktuale në fund të shekullit XIX, ishte ajo se liria fitohet vetëm me anë të luftës së armatosur.

Gjuha e veprës është afër gjuhës së popullit, me mjete të shumta shprehëse, e pastruar nga fjalët e huaja dhe me mjaft fjalë të krijuara nga vetë poeti. Shprehjet frazeologjike, me mjaft ngarkesë emocionale, gjenden dendur në poemë. "Historia e Skënderbeut" mbetet një nga veprat më të rëndësishme të Naimit.

*"Ishte mbret i bukurisë,  
si dielli epte dritë...,  
... kish të gjitha mirësitë  
dhe të tërë urtësinë,  
njerëzin` e dituritë  
dhe fuqin` e trimërinë"*.

Në panteizmin e Naimit depërton edhe humanizmi, besimi i madh i poetit te njeriu, që është qenia më e lartë e gjithësisë, sepse tek ai, sipas poetit, personifikohet vetë hyjnia.

## KAPITULLI I TRETË

### *Identifikimi i njeriut me të bukurën dhe natyrën*

Çdo epoke ka idealet dhe mitet e veta. Një ndër mitet e romantizmit ishte femra. Shkrimtarët romantike në të shumtën e rasteve e kanë mistifikuar edhe gruan edhe ndjenjën e dashurisë. Shpesh portretet që kanë nxitur ndjenjën e tyre erotike i kanë veshur me misteret e imagjinatës së shqetësuar. Paradokset ishin në gjakun e tyre. Ndonëse me vonesë, edhe në letërsinë shqipe janë shprehur tiparet e romantizmit sa i përket erotikës, duke marrë më vonë edhe ngjyrën e kohës dhe të atmosferës së vendit; e shprehje të veçantë kanë gjetur në poemthin erotik-estetik “Bukurija”. Kategoria estetike e të bukurës, sipas Naimit, është imanencë e natyrës. Poemthi Bukurija është përpjekje racionale dhe iracionale për të vënë në gjendje të palëvizshme karakterin tranzitor të kësaj ndjenje më fisnike në jetën e njeriut, për ta sjellë atë në situatë që t’i rezistojë tehut të kohës dhe shpejtësisë së ndryshimit.

Poemthi në fjalë përmban të gjitha pikëpamjet, persiatjet, lektisjet dhe emocionet e poetit: mendimtar, romantik ekzotik dhe sentimental. Aty shihet qenësia e tij shpirtërore, sepse kjo poezi shpreh vibracionet e natyrës së tij humane. Pra, aty e gjejmë të kompletuar edhe një herë mendimtarin, moralistin, estetin dhe poetin skofiar. Është thënë se sa më i madh të jetë njeriu shpirtërisht, aq më i lartë dhe më njerëzor është qëndrimi i tij ndaj femrës. Në Bukurinë e Naimit është bërë identifikimi i kategorisë estetike të të bukurës dhe qenies së njeriut, që rrjedh, gufon prej saj. Po s’mund të thuhet preras se cila është epiqendra e persiatjeve të poetit: femra si krijesë me të cilën njeriu kompletohet dhe ngritet në sferat e lumturisë apo bukuria, të cilën Naimi e merr si përmbajtje objektive, që shquhet veçmas tek gruaja. Sipas Naimit, bukuria nuk varet nga vrojtësi, meqë është imanente tek guri e druri, lulet e yjet, bari e gjethi, toka e qielli: do të thotë tek çdo gjë materiale. Ajo shfaqet pavarësisht prej tij tek dukuritë dhe objektet e ndryshme natyrore, sado në formë të veçantë pikërisht te individi. Për të bukuria — perëndia — gruaja janë një dhe meqenëse plotësohen reciprokisht, domethënë se nëpërmjet femrës, vijnë në shprehje edhe bukuria, edhe hyjnia. Kështu krijohet koncepti se gruaja në njëfarë mënyre është personifikim i bukurisë dhe hyjnisë, që ka mbështetjen në humanizimin e tij.

Duke marrë parasysh një pikëpamje të këtillë nuk është çudi pse ai s'ia del të japë fare portretin e të dashurës së vet, respektivisht nuk cakton elementet portretiste të saj. Ajo nuk mund të përfytyrohet, nuk dihet ç'pamje ka, cilat janë tiparet e fytyrës së saj, cila është ngjyra e zërit të saj, çfarë kualitetesh shoqërore dhe morale ka. Nuk mund të deshifrohet natyra e kësaj krijesë, e as të caktohen vijat e përgjithshme të pamjes së saj. Aq më pak, Naimi jep mundësi të depërtojmë në mendjen e saj, apo të kuptojmë shkaqet përse e refuzoi dashurinë e tij të zjarrtë. Prania e saj në imagjinatë nuk është prani e krijesës prej mishi e gjaku, por e përfytyrimit që fanitet në formë femre të një bukurie të pashoqe. Një dukuri e zakonshme në poemthin “*Bukuria*” është mistifikuar ashtu deri në pikën e fundit. Gruaja si simbol i bukurisë, ajo grua të cilën e dashuron ai përmbledh shkëlqimin farfuritës të diellit, të dritës e ditës, madje jo brenda një kohe të shkurtër, por gjatë tërë jetës, sepse e tillë i bëhet kur ia sodit: “Gush’ e krahuar’ (Paqez’ e ballë) Dhe pulp’ e llerë, (Sy e qepallë) Dhe këmb’ e duar!”.

Bukuria si dukuri imanente e natyrës është ajo që çel lulet, që ndikon të zbukurohen e të stolisen me dekorin që ua ka dhuruar natyra, të qeshin e të gëzohen. Drandofillja si simbol në vargjet identifikohet me objektin e dashurisë së tij, me gruan, dhe ai është me të tani po në atë relacion në çfarë janë edhe bylbyli e drandofillja. Ajo nuk i flet atij, por duke e shikuar se si përpëlitet nga vuajtjet që ia shkakton zjarri i brendshëm, ndjen kënaqësi të madhe dhe zbukurohet përherë e më tepër. Me kohë intensiteti i vuajtjeve të tij vjen duke u shtuar, kështuqë dikur nis e çon edhe natën pa gjumë. Prej simbolikës poeti kalon në veten e parë dhe thotë: edhe në qoftë se gjendet dot njeri t’i thotë se e dashura e tij ka zemër si guri, ai s’do t’i besojë por, kur kupton se kjo qenka e vërtetë e hidhur, ai nuk pëson kurrfarë ndryshimi sa i përket përkushtimit emocional. Përse ndodh kështu? Padyshim për arsye se poeti nuk ka të drejtë të hidhërohet ndaj të dashurës, sepse, siç është thënë, ai dashuron bukurinë dhe objektet e fenomenet që shfaq ajo.

Femra për të cilën flet Naimi s’ka origjinë as moshë të caktuar, s’ka lindur as nuk do të vdesë: ajo është vetëm fanitje e imagjinatës së stuhishme. Ajo është si feniksi që vdes dhe krijohet prej hirit të vetvetes. Poeti ka zgjedhur materien poetike që ta krijojë ashtu sikundër i përgjigjet natyrës dhe konceptit të tij filozofik. Gruaja që e imagjinoi ai nuk mund të përfytyrohet në kohë as në hapësirë; ajo s’ka kurrfarë dimensionesh konkrete, ajo është ide abstrakte. Të gjitha epitetet që ia vesh, virtytet dhe tiparet e saj s’përkojnë me sensibilitetin e

kohës e as me temperamentin dhe mentalitetin e njerëzve të trevës shqiptare. Mund të thuhet, prandaj, se bukuria e Naimit është bukuria filozofike, gruaja e imagjinatës së tij është grua e imagjinatës ekzotike.

### *Glorifikimi i natyrës*

Naimi e sheh vendin e vet ashtu siç do të donte ta shihte e jo sikundër ishte. Botën e tij emotive e nxisin kualitetet etnike dhe veçoritë e tjera kombëtare që i sheh nëpër spektre ngjyrash më të bukura. Ai është optimist i madh sa i përket perspektivës historike të shqiptarëve, damkos e mallkon të gjithë ata që nuk veprojnë në emër të saj dhe, që t’ua zgjojë vetëdijen historike të tjerëve, e aksenton sa e sa herë besimin e tij (Përse, “Gjuha jonë”, “Shpre”, “Tradhëtorët”, “Korça”, “Parajsa”, “Shkëndij’ e diellit ndaj manushaqesë”, e të tjera).

Romantikët rëndom janë njerëz të rebeluar të cilët, duke iu rreshtuar realitetit shoqëror të kohës së vet, ndërtojnë botën e tyre imagjinative, utopike. Pa marrë parasysh se a janë të pakënaqur për shkaqe të brendshme apo të jashtme çfarë ndodh më së shpeshti, ata i zgjerojnë dimensionet e Unit të vet nëpër të cilin filtrojnë krajetat dhe shpresat e tyre. E vetmja specifike që i afron me romantikët e vendeve të tjera, e sidomos me ata të vendeve të robëruara sikundër ishte Shqipëria, është kulti i të kaluarës, i folklorit, i virtytit kombëtar, është patriotizmi i flakët i shprehur përmes veprave të tyre. Edhe glorifikimi i natyrës nga ana e romantikëve tanë e sidomos nga ana e Naimit, ka të bëjë, kryesisht, me glorifikimin e virtytit kombëtar, të trevës dhe të trashëgimit të tij historik. Ky adhurim i natyrës dhe i të kaluarës ka për qëllim forcimin e ndjenjës dhe të vetëdijes kombëtare si dhe të krenarisë për totalitetin njerëzor dhe natyror të vendit. Duke krijuar mitet, duke zgjeruar dimensionet heroike të së kaluarës, ai mbërrin efekte në të dy anët: zbut presionin subjektiv me të cilin e shtyp e tanishmja dhe ndikon tek të tjerët, lexuesit e tij. Prandaj angazhimi i vetëdijshëm moral kombëtar, social dhe shoqëror-politik është indi që përcillet nëpër veprat e të gjithë shkrimtarëve të Rilindjes sonë kombëtare. Një projektim i Unit personal dhe i Unit kombëtar në poezi pikaset veçmas në “*Bagëti e Bujqësi*”, që është vepra e cila ngërthen më së miri këtë veçori të romantizmit të tij. Këtu ai në fillim shkruan:

*Mën,dje, mer fushat e malet, jashtë, jashtë nga qyteti,*

*Nga brenga, nga thash-e-themet, nga rrëmuja, nga rrëmeti.*

Kjo do të thotë se dëshiron të braktiset nga vorbullat e civilizimit, nga ai purgator i njerëzisë dhe të dalë e të gjejë prehje në pafaj sinë e natyrës kombëtare, aty ku janë ruajtur bukuria, modestia, çiltëria e njeriut, e gjësendit, aty ku çdo gjë është e pastër dhe e kthjellët pors në fillet e ekzistencës. Njëherësh kjo do të thotë se ai zhuritet t'i kthehet natyrës edhe që të gjejë prehje, edhe që të nivelizohet me subjektet e objektet e saj. Ky është ai element universal romantik, sado këtu shprehet edhe dimensionin kombëtar i veprës së tij. S'mund të përshkruhet se sa të bukur e sheh ai vendin e vet të largët; se sa të hijshme i sheh fushat e malet; se sa të lumtur njerëzit. Ai nuk don të vërejë askund farë problemesh shoqërore, skamje, sëmundje, as dëshpërime. Të duket sikur krijon njëfarë parajsë, në të cilën Dante i shpjegonte vetëm miqtë dhe dashamirët e vet. Por në veprën Bagëti e Bujqësi kundërmojnë dhembja, nostalgjia, malli, zhuri, sepse poeti jeton larg vendit të vet dhe prej së largu e sheh si nëpër mjegull, në të vërtetë e projektton me imagjinatë ashtu si ia ka ënda. Ajo është dhembje e përshkruar me mall për diçka që e dashuron pa masë, por që nuk mund ta arrish, nuk mund ta shikosh, nuk mund ta prekësh. Mund të thuhet, prandaj, se në këtë poemth bukolik-lirik është realizuar dëshira e patriotit, humanizmi i tij, esenca e njeriut dhe e poetit.

Glorifikimi i natyrës në këtë poemth, ndërkaq, nuk e pason vetëm lektisjen e tij që t'i reshtet vetmisë dhe ta bëjë natyrën të vetmin mile të lumturisë njerëzore. Ai ka shkaqe shumë më të mëdha: t'ia çelë sytë dhe t'ia vejë në lëvizje ndjenjat çdo vendasi, nga njëra anë dhe të mohojë disi atë realitetin ku jetonte, nga ana tjetër. Sikundër është vënë në dukje edhe deri tani, poeti e shkruan këtë vepër pikësëpari që t'ua forcojë ndërgjegjen dhe besimin në veten të gjithë atyre që ishin rralluar emocionalisht ndaj vendit të tyre.

Prandaj edhe mund të thuhet se subjekti i këtij poemthi të pa subjekt është dashuria ndaj Atdheut, është bukuria e tij. Që të shquhet kjo bukuri dhe të gjenden arsyet e dashurisë së tij janë spikatur të gjitha objektet dhe sferat e jetës e të natyrës: bimët, shtazët, ajri, njerëzit; mandej, mirëqenia, lumturia, mirëvajtja, harmonia mes banorëve, e të tjera. Elemente të shumta atraktive janë futur që të bëjnë të bindshme fjalën poetike dhe të nxisin ndjenjën.

## KAPITULLI I KATËRT

### Skënderbeu si mit kolektiv dhe realitet historik

Për Naimin është punë e pamundshme ta riprodhojë realitetin historik pikërisht sipas fakturës së tij. Ai sheh ashtu siç ia don qejfi, siç e prijnë emocionet. Megjithatë, prej shkrimtarëve tanë, përveç Fan Nolit, asnjëri s'ia ka dalë të mishërohet me historinë kombëtare porsì Naimi. *“Historia e Skënderbeut”* dhe *“Qerbelaja”* janë dy vepra të frymëzuara në temën e historisë dhe të krijuara sipas parimit të njëjtën: luftës midis të mirës e të keqes, gënjeshtres e të vërtetës. Shtresa e të parës është po ky dualizëm, vetëm i bazuar në mitin kombëtar mbi Skënderbeun, kurse e të dytës i bazuar në mitin religjioz. Derisa tek *“Qerbelaja”* theksohet mirësia e mbështetur mbi religjionin, në *“Historinë e Skënderbeut”* theksohet trimëria dhe përkushtimi ndaj Atdheut, si virtyte më të larta të njeriut. Ky dualizëm, ndërkaq, bën që personazhet e këtyre dy veprave të dalin të njëanshme. të zgjatura në paskajshmëri në një orientim të tyre, pa ndonjë plotni psikologjike e jetësore.

Naimi nuk mund ta shohë njeriun në totalitetin e tij, sepse ai për të është vetëm i mirë, ose vetëm i keq; ose vetëm bartës i dritës, ose vetëm bartës i errësirës. Edhe pse kjo vepër kap një periudë lufte të paprerë, kur njeriu pëson përjetime të posaçme, kriza, kthesa dhe trajta të gjithfarshme emocionale, personazhet e saj me pak përjashtime janë vetëm të ravizuar, janë porsì figurantat që dalin në skenë e s'luajnë dot farë roli: të tillë gati të gjithë janë përpos Skënderbeut. Dhe ata janë të veçuar: më njerën anë vijjnë personazhet e ngjyrosur në të zi, e në anën tjetër, ata në të bardhë. Të parët i karakterizon apetiti që të pushtojnë dhe vetëm të pushtojnë, kurse të dytët urrejtja e pashuar ndaj atyre gllabëruesve të lirisë dhe të pavarësisë së njeriut.

Megjithatë, ky polaritet ndjenjash nuk i kompletton psikologjikisht ato personazhe mbasi nuk janë të vënë në situata dhe konflikte të shumta të botës së brendshme. Mbi të gjitha këto, Historija e Skënderbeut shënon kulmin e përpjekjeve të vetëdijes patriotike të Naim Frashërit, në kohën kur, pothuaj, të gjithë popujt e pushtuar nga otomanët kishin fituar pavarësinë. Prandaj, këtu më vendosmënisht se sa përpara shtrohet imperativi i luftës, i bashkimit, i lirisë. Mungesa e koherencës, e dramacitetit të veprës është shkak i besnikërisë së autorit ndaj fakturës historike; ajo qëndron ndërmjet një kronologjie të shkruar në vargje dhe epit. Si formë, epi shfaqet vonë në



letërsinë shqipe në krahasim me letërsinë kombëtare të popujve të tjerë, porse përjashtimi mund të ketë shkaqet e veta. Naimi, vërtet, jeton në Turqi, por shpirtërisht dhe psikikisht e ndjen veten prezent në Atdheun e tij. Epi i tij duhet të bëjë sintezën e virtytit nacional në të gjitha planet me qëllim që të jetë pasqyrë e të kaluarës heroike të Popullit shqiptar. Duke krahasuar veten, gjendjen e vet me atë të kaluar të lavdishme, shqiptarët duhet të marrin mësim prej saj, të krenohen pse është kohë e zulmës së tyre të dikurshme dhe të jetë krenaria shkak i forcimit të vetëdijes së tyre.

*“Historija e Skënderbeut”* është vepër me rëndësi të madhe në letërsinë tonë, në radhë të parë përkaq efekti që ka ushtruar në një moment vendimtar të jetës së Popullit shqiptar. Në të është shtruar e zgjidhur një e vërtetë historike: e vërteta e ngadhënjimit moral të të voglit mbi të madhin. Kjo vepër e afirmon, e ngrit, e humanizon mbrojtjen kundër dhunës dhe e provon filozofinë aktiviste dhe etikën e Naimit. Ne të gjithë e njohim, pak a shumë, historinë tonë kombëtare dhe për ne kjo vepër e Naimit nuk sjell ndonjë moment a ngjarje të re të historisë së periudhës së Skënderbeut. Mirëpo, ai që do ta lexonte për herë të parë Historinë e Naimit do të mahnitej nga patriotizmi dhe trimëria e atyre burrave, do të mahnitej nga qëndresa e një populli të vogël në luftën kundër armikut shumëfish më të madh.

Kjo vepër në të vërtetë është apoteozë e trimërisë, e nderit, e burrnisë, e krenarisë e mbi të gjitha apoteozë e lirisë dhe e pavarësisë. Aty është shprehur filozofia e Naimit, humaniteti i tij dhe morali i lartë lirishtashës. Ideja filozofike e kësaj vepre është kuptimplotë: aty vërehet se sa e mundimshme, por kurrë e kotë, është lufta e të mirës kundër të keqes dhe aty mund të shihet se e keqja duke mos zgjedhur mjetet i kanoset njeriut, shoqërisë, të mirës në jetë. Poeti ia ngrit monumentin meditativ-poetik të mirës dhe qëndresës njerëzore, shpresës dhe ngadhënjimit të saj. Skënderbeu është vazhdimisht ngadhënjimtar, sepse është vën në shërbimin e të mirës dhe të të drejtës; ai lufton njëzet e pesë vjet pa pësuar asnjë humbje; për më tepër mbi fitoret e tij luftarake qëndrojnë fitoret e tij morale e njerëzore. Ngado që të shkojë, Skënderbeu sjell me vete gëzim, lumturi, mirëqenie; e ngado që të shkojë pushtuesi sjell me vete kob, zi, kufoma, skamje, uri, robëri. Në ballafaqimin e këtyre dy fuqive është shprehur lufta jetike e njerëzimit lirishtashës kundër pjesës së tij të errët. Dhe kjo luftë e këtyre dy parimeve kundërshtarë është e gjatë, është e vështirë, sepse e keqja është si hidra: porsa i pret kokën, menjëherë i del tjetra. Edhe orvatjet e

njeriut, prandaj duhet të jenë të papushueshme, ashtu sikundër nuk shihet Skënderbeu me ushtrinë e vet të marrë frymë lirisht asnjë çast.

*“Historija e Skënderbeut”* është përplot gjak, kufoma, varre në një anë dhe ngadhënjim njeriu, krenari e anteizëm, nga ana tjetër. Edhe pse nuk largohet gati fare prej dokumentit historik të Barletit, Naimi i jep dimensione të gjera fytyrës madhore të Skënderbeut dhe e ngrit atë njeri (të ngritur me veprat e veta luftarake dhe morale) në nivelin e simbolit kombëtar të luftës për liri e pavarësi. Në të vërtetë, Skënderbeu është mit kolektiv i Popullit shqiptar dhe Naimi i nxjerr në dritë edhe njëherë të gjitha anët e domethënies së këtij miti. Në kuptimin e fjalës mit duhet të bëhet një dallim: derisa mitet kolektive, ruhen rrugës së ndërdijes, miti i Skënderbeut në kuptimin e Naimit është një realitet historik, i cili është ruajtur dhe ruhet në vetëdijen e popullit. Shëmbëlltyra e tij në veprën e Naimit zgjerohet në shumë drejtime e shumë sfera. Në kohën e këtij trimi Naimi sheh mirëqenie, rehati dhe barazi shoqërore, edhe pse e vërteta histori ke nuk është e tillë.

Heroi i tij është i madh jo vetëm si ushtarak, burrë shteti e pris, veçse mbi të gjitha si njeri. Prej historisë mund të mësohet se sulmet e pareshtura të hidrës turke e kishin shkretuar vendin, e kishin rralluar popullsinë, e kishin shtuar mjerimin e dergjën fizike. Po romantiku Naim nuk ka sy as veshë për atë kataklizmë sociale dhe shoqërore: ai don të shohë vetëm fuqinë e ngadhënjimit moral dhe patriotik të njeriut. Me një fjalë, atë e intereson vetëm ana morale dhe patriotike e historisë dhe këto aspekte të saj i afirmon me tëra mjetet e shprehjes: me figura e retorike. Askush në letërsinë shqipe nuk i ka shkruar kësi hynim trimërisë, madhështisë historike të popullit të vet në një periudhë tragjike të tij me të vërtetë; askush para as mbas tij nuk e ka ngritur aq lart Skënderbeun.

Skënderbeu i tij nuk është i vetmuar sikundër mund të jenë dhe në realitet janë heronjtë e epeve, ai ka masën e gjerë mbas vetes dhe kjo i kushtëzon fitoret e tij. Prej saj, prej entuziazmit dhe patriotizmit të kësaj mase ai merr frymëzimin, fuqinë, shpresën, durimin dhe qëndrueshmërinë. *“Historija e Skënderbeut”* është një poemë e tragjikes sonë kombëtare, por edhe poemë e krenarisë sonë. Poezia e saj i është kushtuar ngadhënjimit të ndjenjës liridashëse, ngadhënjimit të moralit dhe të dinjitetit njerëzor. Në këtë vepër ushtrojnë trimëria e qëndrueshmëria, sepse janë të frymëzuara prej vetëdijes mbi luftën e drejtë për mbrojtjen e integritetit kombëtar. Historia e

Naimit është një histori e trimërisë, histori e flijimit për idealin më të lartë e më të shenjtë të njeriut: Lirinë. Skënderbeun, heroin e këtij epi nuk e asgjësojnë sulmet e pareshtura të armikut, atë s'e asgjësojnë as njeriu i tërbuar, as hekuri, as çeliku: atë e harr fizikisht vetëm vdekja, kjo imanencë e jetës njerëzore:

*Atë që s'e zinte shpata*

*dhe ushta, e shigjeta,*

*smundja me duar të thata*

*nër roba e shtu e shkreta!*

(XXI)

Kështu, njeriu i ngritur me fuqinë e poezisë në pedestalin e Mbinjeriut, sillet në nivelin e qenies njerëzore, kësaj qenie të mortshme, thuhet poeti don të japë këtë porosi: edhe disfata edhe fitorja në fund janë disfatë para fuqisë së domosdosë jetësore që i thonë vdekje. Mirëpo, edhe ajo që është thënë përpara, ai heroizëm tragjik, që është ngritur e bërë mit i historisë nëpër emrin e Skënderbeut, ruan porosinë tjetër: vdesin njerëzit, por s'vdesin orvatjet dhe pësimet e tyre. Vdekja e Skënderbeut sipas domosdosë së natyrës në të vërtetë është vdekje e famshme, vdekje që të lind gjithnjë e më i madh para breznive, si simbol i qëndresës dhe i trimërisë së pashoqe që frymëzon, që sjell nder, që e mëson njeriun të bëjë çmos për të dëbuar të keqen nga gjinia njerëzore. Tamam siç ka thënë Herakliti: “*Vdekje e famshme (që) ka dhurate të madhe*”.<sup>10</sup>

---

<sup>10</sup> Po aty, Rexhep Qosja. Porosia e madhe. Tiranë, 1989.

## **Përfundim**

Për Naim Frashërin dhe veprën e tij, është shkruar shumë dhe vazhdon të shkruhet edhe më tutje. Unë, në trajtimin e këtij punimi, jam përpjekur të paraqesë vështrime të krijimtarisë së tij letrare dhe të nxjerrë përfundime, veçanërisht në veprat për të fëmijë dhe të rritur.

Në këtë qasje, me theks të veçantë trajtohet rëndësia dhe nevojat e kohës për krijimin e letërsisë dhe të teksteve tjera për fëmijë. Krahas kësaj letërsie paraqitet nevoja për hapjen e shkollave shqipe dhe pajisja e tyre me tekste shkollore në gjuhën shqipe. Prandaj, Naimi, bëri përpjekje të vazhdueshme që këto tekste t'i përmbushin kërkesat, të jenë sa më tërheqëse dhe të kapshme për fëmijë, duke i kushtuar kështu një rëndësi figurave që janë përdorur, për të krijuar situata nga më të ndryshmet dhe të këndshmet për ta. Këto krijime, i ka lëvruar në zhanre të ndryshme si në: poezi, prozë, tregime, fabula etj.

Ajo që vlen të theksohet për veprën e Naimit, është mesazhi që përcjellë me veprat e tij, jo vetëm për fëmijë, por në përgjithësi. Ai, i kushtoi një vëmendje të madhe rolit në kumtin e përgjithshëm, duke ndikuar në ngjalljen e ndjenjave njerëzore, të mirëkuptimit në mjedisin e bashkëjetesës së njerëzve. Prandaj, këtu haset gjithmonë dhe mbizotëron ndjenja e dashurisë, mirësisë, bashkëpunimit, moralit dhe humanizmit njerëzor.

Vepra e tij siç e kemi trajtuar, është mjaft e gjerë dhe e shumanshme, çfarë dëshmon talentin dhe përgatitjen e tij të shumanshme. Krahas kësaj, është edhe përkushtimi i tij që me krijimet letrare, dhe angazhimet tjera punoi pareshtur për të arsimuar dhe edukuar masat e gjera të popullsisë shqiptare, që në këtë kohë gjendja ishte mjaft e vështirë. Ai, bëri çmos për të ngjallur shpresat te njerëzit dhe mobilizuar shoqërinë për të mirën e atdheut.

Vepra e tij, prekë shumë segmente, dhe pa marrë parasysh gjininë apo motivin, ka të bëjë me çështjen e atdheut dhe të mirën e përgjithshme. Në këtë periudhë të Rilindjes Kombëtare, ai së bashku me rilindësit tjerë zgjuan ndjenjat kombëtare dhe ngjallën shpresat për çlirimin e atdheut dhe lirinë e tyre. Kujdesi i tij dhe vetëdija, shfaqet duke filluar me veprat kushtuar të vegjëleve, arsimimit në shqip, veprave me motive epike e lirike, e deri te vepra “Histori e Skënderbeut” që shënon kulmin e krijimit epik të kohës, me motiv patriotik duke përkujtuar dhe aktualizuar heroin kombëtar Gjergj Kastriotin-Skënderbeun dhe epokën e tij.

Prandaj, gjithë kjo veprimtari e çmuar, me vlera të shumanshme e bëjnë poetin një figurë të pazëvendësueshme për kohën. Gjatë gjithë jetës së tij punoi parreshtur duke lënë një veprimtari letrare, me vlera të jashtëzakonshme. Prandaj edhe u cilësua si poeti më i madh i Rilindjes kombëtare shqiptare.

## LITERATURA

1. Rexhepi, Abdulla Mbi gramatikën e persishtes të Naim Frashërit, kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore “Qytetrimi perso – iranian në Ballkan”, më 11 mars, 2011, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.
2. Bishqemi, Astrit “ Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë”, Elbasan, 2001.
3. Dedja, Bedri “Tradita dhe probleme të letërsisë shqipe për fëmijë”, Tiranë 1971.
4. Frashëri, Naim, “ E këndimit çunavet Këndonjëtoreja”, copë e dytë, shtypur prej Shoqërisë Drita, Bukuresht 1886, f. 3
5. Frashëri, Naim, “Vepra të zgjedhura 2”, Prishtinë 1978, f. 21
6. Naim Frashëri, Naim, *Varfërija*, Rilindja, Prishtinë, 1986.
7. Naim Frashëri, Naim, Vepra 3, (Istori e Skenderbeut), Rilindja, Prishtinë, 1986, fq. 8
8. Naim Frashëri, Naim, ” Vepra të zgjedhura 2”, Prishtinë 1978, f. 17
9. Bulka, Nonda, “Naimi dhe fabulat”, Nëntori, Nr. 5, 1971, f. 51
10. Rexhep, Qosja, Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi I-III, Rilindja, Prishtinë, 1970.
11. Qosja, Rexhep, (1984): Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi I. Prishtinë: Rilindja, 1984.
12. Qosja, Rexhep, “Porosia e madhe”, Tiranë 1989, f. 120
13. Qosja, Rexhep, Shkrimtarë dhe periudha, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1975, fq.370
14. Xholi, Zija, “Mendimtarë të Rilindjes Kombëtare”, Tiranë, 1987, f. 173